- Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
 - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Shërbimet)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

TABELA E TË DHËNAVE TË SHESHEVE DHE TERMINALEVE TË ADMINISTRUARA NGA TIRANA PARKING								
Nr.	Emërtimi i sheshit	Sipërfaqe parkimi në m2	Sipërfaqe tualete në m2	Sipërfaqe e gjelbër në m2	Nr.durësh copë	Nr. shkurresh copë	Kabina shërbimi copë	Nr.Kosha në copë
1	Aslan Rusi (terminali + parkimi)	8076	21	110	10.0	0	2	8
2	Parkimi te Qyteti Studenti (terminali+ parkimi)	6633	21	180	27.0	0	2	12
3	Parkimi te Selman Stermasi	2200	0	260	12.0	20	1	6
4	Parkimi Nëntokësor te sheshi Skënderbej kuota -6.12 m	6044	65	0	-	0	1	15
5	Parkimi Nëntokësor te sheshi Skënderbej kuota -3.12 m	2098	0	0	-	0	0	6
6	Parkimi Nëntokësor te Ish Stacioni i Trenit kuota -3.63 m	5376	0	0	-	0	1	8
7	Parkimi Nëntokësor te Ish Stacioni i Trenit kuota -7.00 m	5376	0	0	-	0	1	8
8	Sheshi te Avni Rustemi	602	0	92	2.0	30	1	3
9	Sheshi tek Diga e Liqenit	1425	0	195	27.0	215	1	2
10	Parkimi Nëntokësor 7 xhuxhat tek rruga e Elbasanit	4890	15	0	-	0	1	0
11	Sheshi i Parkimit pranë sheshit Italia	5644	6.4	0	-	0	1	0
12	Sheshi i Parkimit pranë Kopshtit Zoologjik	2700.1	0	-	-	-	-	-
Shuma Totale		51,064.10	128.40	837.00	78.00	265.00	12.00	68.00

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1 Larja dhe dezinfektimi i koshave dhe tualeteve (WC)

1.2 Volumet e punimeve

Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë tualetet me sipërfaqe prej 128.4 m², 2 herë në ditë sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

1.3 Metodologjia

- Operatori i shërbimit do të lajë dhe dezinfektojë 2 herë në ditë WC dhe koshat si dhe të kryejë larjen e plotë dhe dezinfektimin e tyre.
- Tualetet detyrimisht do të lahen në të gjithë sipërfaqen, duke përdorur furçë dhe solucione larëse.
- Për të mundur kryerjen e këtij shërbimi operatori i shërbimit do të ketë në dispozicion një numër të nevojshëm koshash rezervë për të zëvendësuar çdo natë koshat e larguar për t'u larë.

1.4 Grafikët e punimeve

- Grafikët e punimeve për larjen dhe dezinfektimin e WC-ve, përgatiten nga Operatori Ekonomik dhe miratohen nga Autoriteti Kontraktor.
- Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga Operatori Ekonomik.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar.

1.5 Rregulla për t'u zbatuar

1. Ky shërbim do të kryhet detyrimisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i koshave të mbledhjes së mbeturinave urbane, etj.

1.6 Mjetet dhe pajisjet

1. Lëndë dezinfektuese dhe aromatizuese për dezinfektimin e WC.

2. Fshesa, kova, shtupa dhe furçë plastike dhe të tjera, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.

2. Fshirja e shesheve dhe terminaleve me krahë.

2.1. Volumet e Punimeve

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar për të gjitha sheshet dhe terminalat sipërfaqen totale prej 51,064.01m² me volumet respektive për secilin prej tyre.

Shërbimi i fshirjes me krahë e shesheve dhe terminaleve do të realizohet me krahë 4 herë në javë nga Operatori i Shërbimit, i cili gjithashtu do të kryejë dhe të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse të parashikuara në metodologji për të gjitha sipërfaqet e përcaktuara që janë parashikuar në listën e shesheve dhe terminaleve me volumet e tyre për shërbimin e fshirjes.

2.2. Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes me krahë i shesheve dhe terminaleve konsiston në:

2.2.1. Fshirjen me fshesë e të gjitha shesheve dhe terminaleve nga punëtorët e Operatorit të Shërbimit.

2.2.2. Operatori i shërbimit duhet të zbrazë, pastrojë vendin përreth dhe të mbajë pastër çdo ditë të gjithë koshat e mbeturinave brenda zonës së kontraktuar.

2.3. Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e shesheve dhe terminaleve do të kryhet sipas grafikut.

b. Për pastrimin Shesheve dhe Terminaleve në raste të veçanta Autoriteti Kontraktor mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit dhe gjelbërimit përgatiten nga Operatori i Shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti Kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të mjeteve për sheshe të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Oraret e operimit në secilin shesh dhe terminal.

2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit.

f. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë.

4 Rregulla për t'u zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen sheshe dhe terminale të papastruara apo mbeturina të palarguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të

jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.

b. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

c. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë sheshet dhe terminalat më shumë se një herë pa shpenzime.

d. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

f. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren të gjitha masat paraprake për pajisjen me to të punëtorëve nga ana e Operatorit të Shërbimit.

g. Gjithashtu punëtorët e pastrimit duhet të përfitojnë trajtim special në përputhje me normat higjienike në fuqi për shkak të llojit të punës që kryejnë.

5. Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a.** Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, kaci, karroca dore, lopata, etj për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b.** Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, kruajtëse, lopata, kazanë dore lëvizëse dhe karroca dore.

3. Fshirja e Shesheve dhe Terminaleve me makineri teknologjike

3.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar paraprakisht sheshet dhe terminalat për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me makineri teknologjike fshesë të gjitha sheshet dhe terminalat e përcaktuara në zonën që do të kontraktohet në një sipërfaqe prej 51,064.01m². Ky shërbim do të kryhet 2 herë në javë, në oraret e përcaktuara në grafik.

3.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbimi i fshirjes me makineri i shesheve dhe terminaleve konsiston në:

a. Fshirjen me makina teknologjike fshesë të të gjithë shesheve dhe terminaleve, duke mbuluar gjithë sipërfaqen të lirë nga parkimi i mjeteve të përcaktuara në zonën e kontraktuar. Në të gjitha sipërfaqet e lira nga parkimi, të përcaktuara në volumet e shërbimit të fshirjes me makineri, fshirja detyrimisht duhet kryer me makinë teknologjike. Në rast të kundërt, do të konsiderohet i pavlefshëm shërbimi i kryer.

b. Pas fshirjes me makineri teknologjike, punëtorët e pastrimit të fshirjes me krahë pastrojnë çdo lloj mbeturine të mbetur nga procesi teknologjik i fshirjes, në mënyrë që sheshet të jenë plotësisht të pastra. Edhe ky shërbim manual pastrimi përfshihet në procesin e fshirjes si dhe në çmimin për njësi të saj.

c. Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, në të cilat është e pamundur kryerja e pastrimit me mjete teknologjike. Në vendet ku është e pamundur të kalojë fshesa anësore e makinës teknologjike, (si psh. poshtë makinave apo

kur ka pengesa të tjera), Operatori i Shërbimit duhet të pastrojë me punëtorë të shërbimit me krahë.

3.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Fshirja e shesheve dhe terminaleve do të bëhet sipas grafikut.

b. Fshirja me makineri teknologjike do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me qëllim që zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës së kontraktuar, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti Kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të mjeteve për sheshe të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë:

1. Oraret e operimit në secilin shesh dhe terminal.
2. Llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, përdorimin e makinave teknologjike, rregullave dhe cilësisë së kërkuar.

3.4 Rregulla për tu zbatuar

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen sheshe të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to (rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike). Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik.

b. Do të konsiderohet e pavlefshme fshirja me makineri teknologjike për fshirjen e shesheve dhe terminaleve, kur kjo e fundit gjatë procesit të punës operon me shpejtësi më të madhe se 3 km/orë.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, shoferëve dhe pajisjeve për fshirjen e rrugëve.

d. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë sheshet dhe teminalet më shumë se një herë pa shpenzime.

e. Ndalohet në mënyrë kategorike ngritja e pluhurit gjatë proceseve të fshirjes në sheshe dhe terminale, për shkak të ndotjes që shkaktojnë.

3.5 Mjetet dhe pajisjet

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të shesheve dhe terminaleve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

a. Makina teknologjike për fshirjen e shesheve dhe terminaleve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qëndrore

rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës.

- b. Makineritë teknologjike që do përdoren për shërbimin e fshirjes duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë dhe të jenë konform normave teknike të Komunitetit Europian.

Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:

- a. Të gjitha automjetet të cilat duhet të përdoren nga operatori i shërbimit për fshirjen e shesheve dhe terminaleve, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti Kontraktor për gjëndjen e gatishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b. Çdo makineri për fshirjen e shesheve dhe terminaleve duhet të lahet dhe pastrohet në fillim ose në fund të itinerarit ditor dhe duhet të jetë e pajisur me një sistem pompimi uji i cili shërben për mbrojtjen nga pluhuri.
- c. Një listë e makinave fshirëse do t'i paraqitet Autoritetit Kontraktor përpara fillimit të veprimtarisë së fshirjes.

4. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta dhe drurëve dekorative.

4.1 Volumi i punimeve

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar paraprakisht sipërfaqet e gjelbërta, numrin e drurëve dekorativë dhe numrin e shkurreve.

Operatori i shërbimit do të mirëmbajë një sipërfaqe të gjelbër prej 837m², 78 drurë dekorativë dhe 265 shkurre.

4.2 Specifikime teknike dhe metodologjia

Shërbim i mirëmbajtjes i sipërfaqeve të gjelbërta, drurëve dekorativë dhe shkurreve, konsiston në:

Mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta duke kryer të gjitha proceset agroteknike si:

- Pastrim me krëhër i barit 2 herë në muaj.
- Nitrifikim i sipërfaqes së barit 6 herë në vit.
- Kositje bari me kose 10% e sipërfaqes 1 herë në muaj.
- Vadtje tapet bari 2 herë në javë.

Mirëmbajtjen e drurëve dekorativ dhe shkurreve:

- Prashitje 1 herë në muaj.
- Krasitje drurësh deri 20 vjet 2 herë në vit ose 2 herë në vit.
- Prashitje + plehrim me pleh kimik 2 herë në vit.
- Punim rreth kurorës 1 herë gjatë periudhës së kontraktuar.
- Vadtje 2 herë në javë.

4.3 Plani i punës dhe grafikët e punimeve

a. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit, përgatiten nga Operatori Ekonomik dhe miratohen çdo vit nga Autoriteti Kontraktor.

b. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: ditët e operimit dhe procesi që do të kryhet.

4.4 Mjetet dhe pajisjet

1. Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune si krëhër, gërshërë krasitje, cap, shat, bel, etj për të mundur kryerjen me cilësi të shërbimit.

5 Larja speciale dhe periodike e Shesheve dhe Terminaleve

5.1 Volumet e Punimeve

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar paraprakisht sheshet dhe terminalët, sipërfaqet e tyre, në të cilat do të kryhet shërbimi i larjes speciale periodike për të gjithë sheshet dhe terminalët dhe volumeve të tyre për shërbimin e larjes speciale periodike. Operatori i shërbimit do të kryejë larjen speciale periodike me presion, 1(një) herë në javë në një sipërfaqe prej 51,064.01m².

5.2 Specifikimet teknike dhe metodologjia

Shërbimi i larjes speciale periodike me makineri teknologjike dhe punëtorë ndihmës, konsiston në:

a. Larjen e të gjithë sipërfaqes së përcaktuar duke përdorur tubin anësor për nxjerrjen e ujit me presion dhe bollshëm me një normë harxhimi të ujit gjatë larjes mesatarisht 2 litra/m² dhe punëtorë që pastrojnë me fshesa dhe furçë duke shoqëruar shërbimin e larjes speciale. Qëllimi i këtij shërbimi special periodik është pastrimi total i baltës apo pluhurit që mund të mbetet përgjatë sipërfaqes pas kryerjes së shërbimit të fshirjes, pra eliminimi total i ndotjes nga pluhuri dhe balta.

5.3 Plani i Punës dhe grafikët e punimeve

1. Larja speciale periodike do të bëhet për çdo shesh/terminal 1(një) herë në javë, gjatë gjithë periudhës së kontraktuar, gjithmonë mbas shërbimit të pastrimit (fshirjes) sipas garfikut.
2. Çdo shesh dhe terminal, përcaktuar sipas listës për shërbimin e larjes speciale, do të përfitojë shërbimin e larjes speciale 1(një) herë në javë, duke u larë çdo natë parkime të ndryshme sipas grafikut të këtij shërbimi.
3. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimeve të larjes speciale në shesh/terminalë, përgatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen nga Autoriteti Kontraktor. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor këto ndryshime.
4. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:
 - a. Oraret e operimit në secilin shesh dhe terminal.
 - b. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
 - c. Numrin e punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punime.
5. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
6. Operatori i Shërbimit duhet të rakordojë sipas grafikut të punimeve, duke përfunduar më parë procesin e plotë të fshirjes dhe duke kryer pas përfundimit të këtij shërbimi larjen speciale.
7. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura dhe respektimin e standarteve të kërkuara.

5.4 Rregulla për t'u zbatuar

1. Autoriteti Kontraktor do të inspektojë gjatë ose pas përfundimit të shërbimit, për të siguruar rigorozisht efektivitetin e këtij shërbimi dhe cilësinë e kërkuar.
2. Në të gjitha rastet kur nuk është e nevojshme kryerja e shërbimit të larjes speciale, për shkak të kushteve atmosferike si shi apo ngricë, Operatori i shërbimit nuk do të kryejë këtë shërbim dhe si rrjedhim nuk do të paguhet.

3. Përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor do të shënojnë në proces-verbalet ditore dhe mujore të gjitha ditët dhe volumet përkatëse, që për shkak të reshjeve nuk është kryer shërbimi i larjes speciale dhe mund t'i kërkojë operatori i shërbimit plotësimin e këtij detyrimi gjatë stinës së verës apo ditëve të tjera të vitit, kur është më e nevojshme, pas një kërkesë zyrtare të Autoritetit Kontraktor dhe pagesa do të bëhet atëherë kur të kryhet.
4. Do të konsiderohet e pavlefshme kryerja e këtij shërbimi në kushtet e reshjeve atmosferike të përshkruara më sipër. Do të bëjë përjashtim vetëm në rastet kur kryerja e këtij shërbimi kërkohet nga Autoriteti Kontraktor për shkaqe të ndryshme.
5. Të gjitha shpenzimet për ujin, që do të përdoret për larjen speciale, do mbarten nga operatori i shërbimit.
6. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive dhe pajisjeve për larjen speciale të shesheve dhe terminaleve.

5.5 Mjetet dhe pajisje për larjen speciale periodike të shesheve dhe terminaleve

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse.

1. Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të shërbimit të larjes speciale të rrugëve këto mjete:
Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, pajisur me tub për nxjerrjen e ujit me presion në pjesën anësore të tij, konform normave teknike të Komunitetit Europian.
2. Çdo makineri për larjen e shesheve dhe terminaleve duhet të pastrohet dhe lahet, në fillim ose në fund të itinerarit ditor.
3. Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

TERMAT E REFERENCËS

Larja dhe pastrimi i shesheve dhe terminaleve:

Detyrat: Fshirja dhe pastrim me punëtorë shesh parkimi
Fshirja e rrugëve me makineri
Larja e sipërfaqeve
Larja e wc

Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra

Detyrat: Pastrim me krëher i barit
Nitrifikim i sipërfaqes së barit
Kositje bari me kosë
Vaditje tapet bari

Mirëmbajtje e drurëve dekorativ

Detyrat: Prashitje dru+shkurresh
Krasitje drurësh deri 20 vjet
Prashitje +plehrim me pleh kimik
Punim i parë rreth kurorës
Vaditje

Shpërndarja: Deri në **31.12.2022** duke nisur nga data e lidhjes së kontratës. Fshirja e shesheve dhe terminaleve do të kryhet sipas grafikut.

:

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, referuar nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” ku bilancet e dy viteve, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimin nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se **40%** e vlerës së fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës.
3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar;
4. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e parashikuar në pikën 3, të lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale.

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Shërbime të një natyre të ngjashme **për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar **gjatë tre viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me situacionet për shërbimet e kryera dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plote dhe të suksesshëm të kesaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar.
 - Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur, faturën tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara
2. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- i. Librezë pune
- ii. CV
- iii. Kontratë pune midis tij dhe Operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimin në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjecare të punës së kërkuar me sipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës në ofrimin e shërbimit të pastrimit.

3. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik përkates si me poshte me eksperince pune të pakten 5 vjecare për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompanie e tij për të gjithë periudhën e kërkuar:

1. Inxhinier Mjedis (1) të jetë i pajisur me Certificate nga Ministria e Mjedisit për vlersimin e ndikimit në mjedis, Certificate për Menaxhimin e Mbetjeve. Certificate për menaxhimin e Mjedisit dhe Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (Certificate të mesiperme duhet të ketë inxhinieri i mjedisit ose cdo inxhinier ose specialist që plotëson kriterin 3)
2. Inxhinier Agronom (1)

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës (te vlefshme brenda afatit të vlefshmerisë së ofertes) dhe CV përkatëse, librezat e punës si dhe certifikatat e kerkuara me siper.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

4. Një punësim mesatar i të paktën 44 personave, për periudhën Janar 2022-Mars 2022 të vërtetuar me:
 - a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2022- Mars 2022.
 - b. List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2022- Mars 2022
5. Përveç inxhinierave të siperpërmendur, duhet të rezultojnë të punësuar në listpagese për periudhën e kërkuar personeli teknik i domosdoshëm për kryerjen e punimeve: një inxhinier agronom, një inxhinier mjedisi, një teknik mekanik, shoqëruar me kontratë pune, licensat/ diplome (deftese) profesionale dhe 4 Automakinista të cilët duhet të jenë të paisur me dëshmi e aftësi profesionale ose leje manovrimi (te vlefshme) të lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 4 punonjes (teknik mirembajtje) të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Qendror Teknik ose nga organi kompetent në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, datë 14.02.2013. duhet të rezultojnë të punësuar në listpagese për periudhën e kërkuar. Të paraqiten kontratat e punës si dhe kartelat e lëshuara nga IQT.
7. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar ose mjek të punës të kontraktuar nga jashtë. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, librezë pune, diplomën përkatëse. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumentave si më lart).

Shënim: Kriteret e mësipërme do të përmbushen nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

8. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 9001 – 2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten Iso).
9. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 14001 – 2015** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten Iso).
10. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat **ISO 45001-2018** ose ekuivalent, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten).

Shënim: *Certifikatat e mesiperme (pikat 7 , 8 dhe 9) duhet te jene te leshuara nga Institucione nderkombetare te certifikuara/akredituara.*

11. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).
- a. Leje mjedisore e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për pastrimin, larje rruges, fshirje rrugesh . **(Kodi III.1.A)**
- b. Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL. **(Kodi III.2.A).**
- c. Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane të leshuar nga QKL. **(Kodi III.2.B).**
- d. Licencën DDD me kod II.8.B të lëshuar nga QKL
- (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale pika a, b, c, d)*

12. Kandidati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelen e mëposhtme:

Nr.	Lloji i pajisjeve	Njësia	Sasia	Pronesi/Qera
1	Korrese bari	copë	5	Pronesi/Qera
2	Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 1-1.5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6;	copë	1	Pronesi/Qera
3	Makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 7-9 ton, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës.	copë	1	Pronesi/Qera
4	Makinë teknologjike e vogël për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës deri në 1 ton, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, me tub aspirimi të jashtëm thithës.	copë	1	Pronesi/Qera
5	Makinë vetëshkarkuese, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton.	copë	3	Pronesi/Qera
6	Makinë, me hapje të spondit anësor ose nga pas, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve dhe mirëmbajtje të parkimeve gjatë ditës, me kapacitet mbajtës deri 1.5 ton.	copë	3	Pronesi/Qera
7	Makineri pompe speciale për larje dyshemeje	copë	1	Pronesi/Qera
8	Makineri speciale për fshirjen e pllakave	copë	1	Pronesi/Qera
9	Autobot për ujra të zeza	copë	1	Pronesi/Qera

10	Autobot uji	copë	3	Pronesi/Qera
11	Makineri fshesa korenti per siperfaqet e brendshme(tek parkimet nentokesore)	copë	10	Pronesi/Qera

Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të- paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

